



**FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS  
SPORTSKA STRELAČKA FEDERACIJA KOSOVA  
SHOOTING SPORT FEDERATION OF KOSOVA**

---

Adresa: Rr. Agim Ramadani Nr. 43 Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.  
Tel.Fax: ++381 (0) 38 244 473, mobil: ++377 (0)44 278 700; ++377 (0) 44 181 282  
e-mail: [f\\_sh\\_kos@hotmail.com](mailto:f_sh_kos@hotmail.com), [kosvosshooting@gmail.com](mailto:kosvosshooting@gmail.com)

---

## STATUTI

### I FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 17.05.2008.

Në bazë të neneve 20,27 deri në nenin 37 të Ligjit mbi sportin të Republikës së Kosovës Nr.2003/24, Udhëzimeve Administrative Nr. 01 dhe 02.2005 të Departamentit të sportit mbi regjistrimin e Klubeve, përkatësisht regjistrimin dhe licencimin e Federatave dhe Shoqërive sportive, nenit 23 të Statutit të FSHSK-së, Kuvendi i Federatës së Shenjëtarisë Sportive i Kosovës, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 17.05.2008, pas shqyrtimit të ndryshimeve dhe plotësimeve, aprovoi

## STATUTIN

### E FEDERATËS SË SHENJËTARISË SPORTIVE TË KOSOVËS

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHE

##### Neni 1

- 1.1 Me këtë Statut Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës, rregullonë vëprimtarinë e vetë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, organizimin e brendshëm, qeverisjen, mënyrën e antarësimit dhe pushimin e antarësisë, të drejtat dhe obligimet, emërtimin, selinë, amblemën, mjetët financiare dhe çështjet tjera të rëndësishme për sportin e Shenjëtarinë në Republikën e Kosovës.

##### Neni 2

- 2.1 Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: FSHSK) është e vetmja Federatë e sportit amator të shenjëtarisë sportive, në të cilën antarësohen Klubet e sportit të shenjëtarisë dhe mund të antarësohen edhe organizata tjera të ngjajshme, të cilat kryejnë veprimtari me interes për sportin e shenjëtarisë nga territori i Republikës së Kosovës.

##### Neni 3

- 3.1 FSHSK-ja është person juridik e regjistruar në Divizionin për Regjistrimin e OJQ-ve pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike, nën Nr.Regj.5100469-8
- 3.2 Emri i FSHSK-së është shkruar në Shqip: Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës, në anglisht: Shooting Sport Federation of Kosovo, dhe serbisht: Sportska Streljacka Federacija Kosova. Në marrëdhënjet ndërkombëtare do të komunikoi në gjuhën anglishte.
- 3.4 Selia e FSHSK-së është në Shtëpinë e sporteve në Prishtinë, Rr. Agim

Neni 4

- 4.1 FSHSK-së ka flamurin, amblemen dhe shenjën e vetë.
- 4.2 Shenja e FSHSK-së përbëhet prej katërkënsi me ngjyrë të kaltërt, në brendësi e vendosur harta e Republikës së Kosovës me ngjyrë ari, në të cilën janë vizatur tre rrrathë koncentrik me katër ndërprerje kryqzore me pike të theksuar të zezë në mes, kurse nën hartë ndodhet shkurtesa FSHSK.
- 4.3 Flamuri i FSHSK-së ka ngjyrën e kaltërt sipas përshkrimit në pikën 4.2 dhe raportë të gjatësisë dhe gjërësisë 2 : 1.
- 4.4 FSHSK-ja ka vulën e rrumbullaktë dhe vulën katërkëndshe. Vula e rrumbullaktë ka diametrin 25 mm, rrethit i shkruar emëri i plotë i FSHSK-së në gjuhën shqipe, anglishte dhe serbe, kurse në mes harta e Kosovës, me tre rrrathë në mes me ndërprerje kryqzore dhe pike të theksuar në mes.

Neni 5

- 5.1 FSHSK-ja është themelues dhe anëtare me të drejta të plota në Komitetin Olimpik të Republikës së Kosovës.
- 5.2 FSHSK-ja ka aplikuar për anëtarësim në Federatën Ndërkombëtare të Sportit të Shenjëtarisë (ISSF) dhe në Konfederatën Europiane të Shenjëtarisë (E.S.C).
- 5.3 FSHSK-ja mund të anëtarësohet edhe në organizatat tjera të vendit dhe ndërkombëtare, që janë me interes për sportin e shenjëtarisë, e që nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi të Kosovës

Neni 6

- 6.1 FSHSK-në e përfaqësonë Kryetari i FSHSK-se, kurse në mungesë ose pengesë të tij, njëni nga nënkryetarët që e caktonë ai ose Rekretari.
- 6.2 Për obligimet e marra, FSHSK-ja përgjigjet me të gjitha mjetët e veta (përgjegjësia e plotë).

Neni 7

- 7.1 Puna e FSHSK-së është publike.
- 7.2 Puna publike realizohet me njohjen e organizatave të shenjëtarisë dhe të organizatave tjera të interesuara me programet, vendimet, synimet dhe konkluzionet e FSHSK-së.
- 7.3 FSHSK-ja i njoftonë përfaqësuesit e mjeteve të informimit publike mbi aktivitetet e FSHSK-së, me mbledhjet e organeve, me vendimet dhe

konkluzionet e tyre.

4

#### Neni 8

- 8.1 Federata e Shenjëtarisë Sportive e Kosovës, është Organizatë Joqeveritare Jopartiake dhe Joprofitabile /OJQ/ e themeluar me vullnetin e lirë të qytetarëve për zhvillimin e sportit amator të shenjëtarisë sportive në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

#### Neni 9

- 9.1 FSHSK-ja nuk do të bëjë kurfar shpërndarje të fitimit nëto ose të profitit eventual asnjë individi, por fitimin eventual, do t'a përdorë për mbështetjen e qëllimeve joprofitabile të zhvillimit të sportit të shenjëtarisë në Republikën e Kosovë, pa beneficione të veçanta individuale.
- 9.2 FSHSK-ja mund të bëjë pagesë për punët e kryera me të punësuarit me kontratë, dhe për të arritura sportive deri në shumën e arësyeshme.
- 9.3 Ndonjë transakcion në mes të FSHSK-së dhe të anëtarëve të Këshillit drejtues, personi ose nëpunësi, duhet të mbyllet në vlerën reale të tregut ose në kushtet që janë më të favorshme për FSHSK-në.

## II. QËLLIMI

#### Neni 10

- 10.1 Qëllimi i FSHSK-së është i bazuar në nenin 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02.2005 për zhvillimin dhe përhapjen e sportit amator të shenjëtarisë ndër qytetarët, sidomos ndër të rinjtë pa diskriminim në baza politike, racore religjioze, gjinije dhe forcimin e miqësisë ndërmjet anëtarëve dhe klubeve të shenjëtarisë të të gjitha nacionaliteteve.
- 10.2 Përfaqësimi i shenjëtarisë sportive të Kosovës në botën e jashtme.
- 10.3 Bashkëpunimi me organizatat tjera sportive dhe me organe.
- 10.4 Koordinimi dhe harmonizimi i aktiviteteve programore të anëtarëve.
- 10.5 Përcaktimi i kushteve për organizimin e garave të shenjëtarisë sportive dhe përbërja e disiplinave të garave në Kosovë.
- 10.6 Aprovimi i kritereve unike për formimin dhe regjistrimin e Klubeve të shenjëtarisë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01.2005 të Departamentit të sportit.

- 10.7 Përforcimi i punës profesionale të anëtarët e FSHSK-së duke organizuar seminare dhe ligjerata.
- 10.8 Përcjell dhe shqyrton çështjet aktuale të financimit të sportit të shenjëtarisë, ndërtimin, mirëmbajtjen, qeverisjen dhe shfrytëzimin e objekteve dhe të paisjeve dhe ndërmerr masa të nevojshme në lidhje me këtë.
- 10.8 Organizonë shkollimin dhe aftësimin e referëve dhe trajnerëve të shenjëtarisë.
- 10.9 Kryen edhe detyrat tjera që dalin nga Ligji mbi sportin të Republikës së Kosovës, të vendimeve të Komitetit Olimpik të Republikës së Kosovës dhe të Kuvendit të FSHSK-së
- 10.10 FSHSK-ja qëllimet e veta i realizonë drejtë për së drejti ose nëpërmjet shërbimit profesional të FSHSK-së dhe anëtarëve.
- 10.11 Ndërmerr edhe masat dhe aktivitetët tjera që i cakton Komiteti Olimpik i Republikës së Kosovës në lidhje me pjesëmarrjen e reprezentacionit të Shenjëtarisë sportive në garat ndërkombëtare dhe Lojrat Olimpike.

### III. VËPRIMTARIA

#### Neni 11

- 11.1 FSHSK-ja si sport nacional i kryen edhe këto vëprimtari:
- 11.1.1 - Përfaqësonë Kosovën në shenjëtarinë sportive.
- 11.1.2 - Organizonë kampionatet dhe garat tjera me rëndësi për sportin e shenjëtarisë në Kosovë.
- 11.1.3 - Merr pjesë në pregaditjen dhe organizimin e garave ndërkombëtare të shenjëtarisë me interes për Republikën e Kosovës.
- 11.1.4 - Përfaqësonë sportin e shenjëtarisë të Kosovës në organizatat dhe organet në vend dhe në ato ndërkombëtare.
- 11.1.5 - Ndërmerr masat dhe aktivitetët dhe furnizon pregaditjet dhe pjesëmarrjen e reprezentacionit të Republikës së Kosovës dhe të garuesëve tjerë kulminant në gara.
- 11.1.6 - Për realizimin me suksës të qëllimeve dhe të vëprimtarisë, FSHSK-ja, bashkëpunon me organet shetërore, institucionet arësimore, me institucionet dhe organizatat tjera profesionale, etj.
- 11.1.7 - Furnizonë anëtarët – Klubet me rekuizita dhe material tjetër të nevojshëm të shenjëtarisë.
- 11.1.8 - Të gjitha këto aktivitete për anëtarët e vetë FSHSK-ja, si OJQ i kryen falas
- 11.1.9 apo nën çmimin e tregut.

#### IV. ANËTARËSIMI

##### Neni 12

- 12.1 Anëtar i Klubit të shenjëtarisë mund të jenë çdo qytetar i Kosovës nën kushtet e njajta të caktuara me Ligjin mbi sportin, Udhëzimin Administrativ Nr.01.2005 të Departamentit të sportit, me këtë Statut dhe që paguan anëtarësinë.
- 12.2 Anëtar i Klubit të shenjëtarisë mund të jenë qytetari i shtetit tjetër, nën kushtet të cilat i caktonë Këshilli drejtues i FSHSK-së.
- 12.3 Anëtarët të Klubit të shenjëtarisë mund të jenë:
- 12.3.1 - të rregullt,
  - 12.3.2 – të nderit,
  - 12.3.3 – të merituar.

##### Neni 13

- 13.1 **Anëtar i rregullt** i Klubit të shenjëtarisë mund të jenë qytetari i cili aktivisht bënë pjesë në realizimin e detyrave në Klubin e vetë të shenjëtarisë dhe merr pjesë në ushtrimet dhe në garat, si dhe ndihmon zhvillimin e aftësive shenjëtare të anëtarëve.
- 13.2 Anëtarët e rregullt kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet e Klubeve dhe të FSHSK-së, dhe të gjithë anëtarët e rregullt kanë të drejtë t'i shrytëzojnë shërbimet dhe të drejtat, si dhe të marrin pjesë në të gjitha manifestimet sportive dhe gara, të cilat i organizonë Klubi i shenjëtarisë.
- 13.3 Anëtar i rregullt mund të bëhet çdo qytetar, i cili aplikonë në Këshillin drejtues të Klubit, i cili merr vendim për anëtarësim ose jo.
- 13.4 **Anëtar i nderit** i Klubit të shenjëtarisë mund të jenë qytetari i cili me veprimet e veta në jetën shoqërore dukshëm ka kontribuar në afirmimin e sportit të shenjëtarisë dhe të anëtarëve.
- 13.5 Vendimin mbi shpalljen e anëtarit të nderit e aprovon Kuvendi i Klubit të shenjëtarisë.
- 13.6 Anëtarit të merituar i jepet Çertifikata, në bazë të së cilës i njihen të gjitha të drejtat e anëtarit të Klubit të shenjëtarisë të bazuara në Statut.
- 13.7 **Anëtar i merituar** i Klubit të shenjëtarisë mund të shpallet qytetari, i cili sëpaku 30 vjet është anëtar i Klubit të shenjëtarisë, dhe i cili me aktivitetet e përgjithshme të shenjëtarisë dukshëm ka kontribuar zhvillimit të sportit të

shenjëtarisë ose me rezultatet e arritura përherë e ka afirmuar sportin e shenjëtarisë.

- 13.8 Vendimin për shpalljen e anëtarit të merituar e aprovon Kuvendi i FSHSK-së, në propozim të Këshillit drejtues të FSHSK-së.
- 13.9 Anëtarit të merituar i lëshohet Çertifikata me të cilën i pranohen të gjitha të drejtat e anëtarit të Klubit të parapara me Statut.
- 13.10 Këshilli drejtues i Klubit të shenjëtarisë, kërkesën e qytetarit për anëtarësim në Klubin e shenjëtarisë e rrefuzon në bazë të arsyeve të parapara me Rregullorën disiplinore të FSHSK-së, për përjashtim ose qytetari nuk i plotëson kushtet e parapara me Ligjin mbi armët, përkatësisht të Ligjit mbi sportin.
- 13.11 Me rrefuzimin e pranimit në Klubin e shenjëtarisë jipet arsyetimi në vendim, kundër të cilit qytetari ka të drejtë ankese Kuvendit të Klubit, vendimi i të cilit është definitive.

#### Neni 14

- 14.1 Lartësinë e regjistrimit në Klub, e cakton Klubi, kurse lartësinë e anëtarësisë që i paguhet FSHSK-së, Këshilli drejtues i FSHSK-së për të gjitha Klubet.

#### Neni 15

- 15.1 **Ndërprerja e anëtarësisë** në Klubin e shenjëtarisë mund të bëhet:
- 15.2.1 - me lëshimin e Klubit, në bazë të deklaratës me shkrim të anëtarit,
- 15.2.2 – me përjashtim, në bazë të vendimit fuqiplotë të Kuvendit të Klubit të shenjëtarisë,
- 15.2.3 - me shlyerje, për shkak mosplotësimi të obligimeve të parapara në periudhë të gjatë, ose për shkak të denimit për vepra ndeshkuese, ose kundravajtje nga Ligji mbi armë,.
- 15.2.4 – me vdekjen e anëtarit.
- 15.3 Këshilli drejtues i FSHSK-së për kalim të anëtarit të rregullt në Klub tjetër të shenjëtarisë do t'i caktoj kushtet e veçanta.

### V. ANËTARËT E FSHSK-së, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET

#### Neni 16

- 16.1 Anëtar të FSHSK-së mund të bëhen:

- 16.1.1 - Klubet e shenjëtarisë amatere dhe profesionale që themelohen dhe regjistrohen sipas Udhëzimeve Administrative Nr.01 dhe 02.2005 dhe nënshkruajnë Marrëveshjen për anëtarësim në Federatë.
- 16.1.2 – organizatat tjera, të cilat kryejnë veprimtari me interes për sportin e shenjëtarisë nga territori i Kosovës.
- 16.2 **Klubet e shenjëtarisë** mund të formohen nëse përveç kushteve të parapara me Ligjin mbi sportin dhe Udhëzimin Administrativ Nr.01.2005 plotësojnë edhe kushtet tjera që i cakton FSHSK-ja e që mundësojnë realizimin e detyrave themelore të Klubi në bazë të Statutit dhe akteve tjera të FSHSK-së.
- 16.3 Klubi ka Statutin e vetë, i cili bazohet në dispozitat e Ligjit mbi sportin, Udhëzimit Administrativ Nr.01.2005 dhe të jenë i harmonizuar edhe me këtë Statut.
- 16.4 Organi më i lartë i Klubit të shenjëtarisë është Kuvendi i anëtarëve të Klubit, të cilin e përbëjnë të gjithë anëtarët e rregullt të Klubit.
- 16.5 Kuvendi i anëtarëve të Klubit me vota të mëshehta zgjedh Këshillin drejtues, Kryetarin, nënkryetarin, Këshillin mbikëqyrës, gjyqin e nderit dhe sekretarin.
- 16.6 Këshilli drejtues i Klubit i zbaton vendimet, konkluzionet dhe synimet e Kuvendit, dhe kujdeset për të gjitha çështjet e rëndësishme ndërmjet dy Kuvendët e Klubit.
- 16.7 Anëtar të Klubit nga pika 16.1 të këtij Statuti mund të bëhen organizatat të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin mbi sportin Nr.2003/24 dhe të Udhëzimit Administrativ Nr.01.2005,që i pranojnë rregullat e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe dispozitat e këtij Statuti, si dhe aktet tjera të FSHSK-së.

#### Neni 17

- 17.1 **Të drejtat e anëtarëve janë:**
- 17.2 – që sipas mënyrës së paraparë me Statut dhe me aktet e përgjithshme të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në organet e FSHSK-së.
- 17.3 – që të marrin pjesë në kryerjen e programit të punës së FSHSK-së,
- 17.4 – që të propozojnë masat dhe aktivitetet për përparimin dhe zhvillimin e sportit të shenjëtarisë,
- 17.5 – që në mënyrë të rregulluar dhe sipas kushteve të parapara të marrin pjesë në gara dhe në aktivitetet tjera që i organizonë FSHSK-ja,
- 17.6 - që t'i realizojnë edhe të drejtat tjera të cilat dalin nga Ligji, ky Statut dhe aktet tjera të përgjithshme të FSHSK-së.



## Neni 18

- 18.1 **Obligimet e anëtarëve janë:**
- 18.2 – që rregullisht t'a paguajnë anëtarësinë dhe obligimet tjera monetare ndaj FSHSK-së,
- 18.3 – që në punën e vetë t'i përmbahen Ligjit, këtij Statuti dhe akteve tjera të përgjithshme të FSHSK-së, si dhe të vendimeve dhe të konkluzioneve të organeve të FSHSK-së,
- 18.4 – që të marrin pjesë në kryerjen e Programit të punës së FSHSK-së dhe të organeve të bazuara në te,
- 18.5 – që në punën e veprimtarinë e vetë t'i përmbahen etikës sportive, dhe me sjelljet e veta të mbrojnë prestigjin e sportit të shenjtëtarisë në Kosovë.
- 18.6

## Neni 19

- 19.1 Kërkesa për pranim në anëtarësi, me deshmitë për plotësimin e kushteve sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01.2005 dhe me deklaratën me shkrim mbi pranimin e këtij Statuti si dhe të akteve tjera, i paraqitën Këshillit drejtues të FSHSK-së
- 19.2 Si argumente për plotësimin e kushteve për pranim në anëtarësi konsiderëhen:
- 19.3 - Çertifikata mbi regjistrim në Divizionin e Regjistrimeve të OJQ-ve pran Ministrisë së Sherbimeve Publike,
- 19.4 – Vendimin mbi regjistrimin e Klubit në Drejtorinë për kulturë, rini dhe sport të komunës gjegjëse, dhe
- 19.5 – Deshmitë nga nenet 6,7,8 dhe 9 të Urdhëresës Administrative Nr.01.2005 të Departamentit të sportit.

## Neni 20

- 20.1 Vendimin mbi pranimi e anëtarit e aprovonë Këshilli drejtues i FSHSK-së, i cili mund t'a rrefuzoi pranimin në anëtarësi nëse e vlerësonë se nuk i plotësonë kushtet e parapara të pikës 19.2 të nenit praparak
- 20.2 Këshilli drejtues i FSHSK-së, paraqitësit të kërkesës mund t'ia caktoi afatin, i cili nuk mund të jenë më i gjatë se 90 ditë, që t'i menjanoi të metat për shkak të cilave nuk mund të pranohet në anëtarësi në FSHSK-së
- 20.3 Kundër vendimit të Këshillit drejtues të FSHSK-së me të cilin është rrefuzuar pranimi në anëtarësi, mund të ushtrohet anëkesa Kuvendit të FSHSK-së, në afat prej 30 ditësh pas pranimit të vendimit.
- 20.4 Para aprovimit të vendimit mbi shlyerjen nga anëtareësia, Këshilli drejtues mund të merr vendim mbi caktimin e afatit prej 90 ditësh për menjanimin e arësyeve për shkak të cilave mund të shlyhet nga anëtarësia.

- 20.5 Kundër vendimit mbi shlyerjen nga anëtarësia organizata e shenjëtarisë ka të drejtë ankese në Kuvendin e FSHSK-së në afat prej 30 ditësh prej ditës se pranimit të vendimit.

## VI. ORGANET E FSHSK-së

### Neni 21

Organet e FSHSK-së janë:

- 21.1 – Kuvendi i FSHSK-së,
- 21.2 – Kryetari i FSHSK-së,
- 21.3 – Këshilli drejtues FSHSK-së,
- 21.4 - Këshilli mbikëqyrës,
- 21.5 - Komisionin për anti-doping,
- 21.6 – Gjyqi i nderit, dhe
- 21.7 - Arbitrazhi.

### **Kuvendi i FSHSK-së**

### Neni 22

- 22.0 Kuvendi i FSHSK-së është organi më i lartë i qeverisjes së FSHSK-së.
- 22.1 Kuvendin e FSHSK-së e përbëjnë nga dy (2) përfaqësues të anëtarëve të autorizuar /Klubeve/ të FSHSK-së, nga një (1) përfaqësues i TMK-së, SHPK-së dhe PAK.
- 22.1.1 Numëri i përfaqësuesëve ne Kuvendin e FSHSK-së, mund të ndryshohet në propozim të Keshillit drejtues e të vërtetuar në Kuvend.
- 22.1.2 Nga numri i përgjithshëm i përbërjes 30% janë femra.
- 22.1.3 Çdo përfaqësues i anëtarit në Kuvend ka një (1) votë.
- 22.2 Përfaqësues të anëtarëve në Kuvendin e FSHSK-së si dhe anëtar të organeve të FSHSK-së mund të jenë personat:
- 22.5.1 - që janë shtetas i Republikës së Kosovës,
  - 22.5.2 – që është anëtar i Klubit – organizatës që e përfaqësonë,
  - 22.5.3 - që nuk është i denuar për vepra të denueshme.
- 22.6 Mandati i anëtarëve të organeve dhe i kryetarit të FSHSK-së është katër (4) vjet dhe mund të rizgjedhën përsër.
- 22.7 Anëtarit të organeve dhe Kryetarit të FSHSK-së, mund t’i pushoi mandati edhe para skadimit të afatit në të cilin është zgjedhur në rastet:
- 22.7.1 - e dhënjes së dorëheqjes,

- 22.7.2 – të rrevokimit,
  - 22.7.3 - shkarkimit për shkak të moskryerjes së detyrave apo keqpërdorimeve të rënda, dhe
  - 22.7.4 – të rrethanave për shkak të cilave anëtari nuk mund t'i kryejë më detyrat në organet e FSHSK-së.
- 22.8 Pushimi i mandatit nga pika 22.7, bëhet në mënyrë dhe sipas procedurës së njëjtë për propozimin e zgjedhjes së tyre.
- 22.9 Mandati i përfaqësuesit të anëtarit të mëvonshëm të zgjedhur zgjatë deri në skadimin e mandatit të organit në të cilin është zgjedhur.

### Neni 23

- 23.1 Kuvendi i FSHSK-së kryen këto punë:
- 23.2 Në bazë të konsultimeve paraprake me klubet e shenjëtarisë apo drejtdrejtë zgjedh:
- 23.2.1 - Këshillin drejtues, si organ të vetin egzekutiv,
  - 23.2.2 – Kryetarin e FSHSK-së,
  - 23.2.3 – Këshillin mbikëqyrës,
  - 23.2.4 – Gjyqin e nderit,
  - 23.2.5 - Komisionin për ant-doping,
  - 23.2.6 – Arbitrazhin,
  - 23.2.7 - Nxjerr Statutin e FSHSK-së si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij,
  - 23.2.8 – Nxjerr aktet e përgjithshme,
  - 23.2.9 - Përcaktonë politikën e zhvillimit të sportit të shenjëtarisë,
  - 23.2.10 - Nxjerr Rregullorën mbi punën e Kuvendit,
  - 23.2.11 – Nxjerr Planin dhe programin e punës e FSHSK-së për periudhë ndërmjet dy mbledhjeve,
  - 23.2.12 – Aprovonë Raportin mbi punën për periudhën e kaluar,
  - 23.2.13 – Aprovon Planin financiar vjetor,
  - 23.2.14 – Aprovon Raportin financiar për vitin paraprak,
  - 23.2.15 - Mer vendim mbi pushimin e punës së FSHSK-së,
  - 23.2.16 - Kryen edhe punë tjera të caktuara me ligj, me Rregullat e FSHSK-së dhe me këtë Statut.
- 23.3 Kuvendi nxjerr vendime fuqiplotë nëse në mbledhje (MKV) sigurohet kворumi, pra nëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e përfaqësuesëve të anëtarëve (50% +1). endimet mirren me aklamacion të shumicës prezente, përveç të nxjerrja, përkatësisht plotësimi i Statutit, gjegjësisht ndërprerja e punës së FSHSK-së, kur vendimet mirren me shumicën e votive të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit. Nëse vendoset në Kuvend votimet mund të jenë secrete për çështje të caktuara.
- 23.4 Çdo përfaqësues i anëtarëve në Kuvend mund të përmbahet nga votimi – të apstenoj.
- 23.5 Kuvendi i FSHSK-së mbahet një herë në vit, në mbledhjet e Kuvendit vjetor (MKV), në fillim të çdo viti kalendarik, kur vlerësohet puna njëvjeçaree vitit të kaluar dhe i nxjerr planet dhe programet për vitin në vijim.

- 23.4 Kuvendi i FSHSK-së mund të takohet edhe në mbledhjet e Kuvendit të jashtëzakonshëm (MKJ) kurdoherë që kërkohet nga 2/3 shumicë e anëtarëve ose nga Këshilli drejtues i FSHSK-së.
- 23.5 Kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit i drejtohet Këshillit drejtues, i cili nëpërmjet shërbimit të administratës do t'i njoftoi të gjithë anëtarët. Njoftimi me shkrim për Kuvendin vjetor ose për Kuvendin e jashtëzakonshëm përmbanë datën, vendin e mbajtjes dhe materialet, që duhet dërguar sëpaku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
- 23.6 Puna e Kuvendit më hollësisht e rregulluar me rregullorën mbi punën e Kuvendit të FSHSK-së.

### **Këshilli drejtues i FSHSK-së**

#### Neni 24

- 24.1 Këshilli drejtues është organ kolektiv i Kuvendit të FSHSK-së, i cili ndërmjet dy Kuvendeve zgjedhore i kryen punët e FSHSK-së dhe zbaton vendimet dhe Konkluzionete tijë.
- 24.2 Këshilli drejtues përbëhet prej 11 anëtarëve, prej të cilëve dy (2) femra dhe një (1) nga minoritetet etnike. Kryetari, dy (2) nënkryetar, një (1) anëtar zgjedhen në një periudhë prej katër (4) vitësh, kurse 4 anëtarë zgjidhohen dhe tre (3) anëtar emrohen nga Kryetari për një periudhë prej dy (2) vitësh. Anëtarët e Këshillit drejtues, pas skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhë mund të rizgjedhen.
- 24.3 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit drejtues bëhet me vota të mëshehta.
- 24.4 Ne fletën e votimit, përveç emrave të kandidatëve, prapa emrit shenohen postet për të cilat kandidohen në Këshillin drejtues për t'u zgjedhur.
- 24.5 Anëtarët e Këshillit drejtues për punën e vetë i përgjigjen Kuvendit.
- 24.6 Nëse numri i anëtarëve të Këshillit drejtues për çfardo arsye çoftë zvoglohet për një të tretën e anëtarëve, Këshilli drejtues mund të pranoi anëtarë të rinjë, mandati i të cilëve zgjatë për kohën e mbetur të Këshillit drejtues. Në rastë se numri i anëtarëve të Këshillit drejtues zvoglohet për më shumë se një të tretën, Këshilli drejtues ka për detyrë të thrrasë Kuvendin e jashtëzakonshëm të FSHSK-së për zgjidhjen plotësuese të anëtarëve të Këshillit drejtues.

## Neni 25

25.1 Këshilli drejtues kryen sidomos këto punë:

- 25.1.1 – Zbaton vendimet dhe konkluzionet e Kuvendit,
- 25.1.2 – Pregaditë materialet për mbledhjet e Kuvendit,
- 25.1.3 – Pregaditë propozimet për aprovimin e Statutit dhe të akteve normative, si dhe nryshimet dhe plotësimet e tyre,
- 25.1.4 – I raporton Kuvendit mbi punën e vetë,
- 25.1.5 - Përcjell programin dhe kalendarin e garave dhe i organizonë ato në nivël të Kosovës dhe ndërkombëtare.
- 25.1.6 – Vendosë për pranimin dhe pushimin e anëtarëve të FSHSK-së.
- 25.1.7 - Koordinon punën me institucionet shtetërore, organet dhe organizatat tjera,
- 25.1.8 – Zgjedh Këshillat dhe komisionet e veta.
- 25.1.9 – Pregaditë Projektet dhe i raportonë Departamentit të sportit mbi gjendjen financiare,
- 25.1.10– Organizonë seminare për trajnimin e trajnerëve dhe referëve.
- 25.1.11– Kujdeset për reprezentacionin e Kosovës,
- 25.1.12 - Komunikonë me Federatën Ndërkombëtare të Sportit të Shenjëtarisë dhe me Konfederaten Europiane të Shenjëtarisë,
- 25.1.13 – Ndanë trofe, mirënjhje, përkatësisht shpërblime.
- 25.1.14 - Aprovonë vendime për anëtarësim të FSHSK-së në organizata tjera të vendit dhe ndërkombëtare.
- 25.1.15– Pregaditë planet vjetore financiare dhe llogaritë vjetore.
- 25.1.16 -Aprovon sistematizimin e vendeve të punës të FSHSK-së,
- 25.1.17 - Shpall konkursin për sekretar dhe punëtor dhe i plotësonë vendët e punës sipas sistematizimit,
- 25.1.18 - I propozon Kuvendit kandidatët për anëtarë të nderit,
- 25.1.19 - Kryen edhe punë dhe detyra tjera nga kompetenca e vetë.
- 25.2 Këshilli drejtues takohet sipas nevojës, e sëpaku dy here në vit. Vendimet i aprovon me aklamacion të mbishumicës prezente të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 25.3 Për kryerjen e punëve të caktuara, Këshilli drejtues formonë organe te caktuara – komisione, të përhershme në përbërje prej 3 deri 5 anëtar, të cilët në mes veti zgjedhin kryetarin, si janë:
  - 25.3.1 - Komisionin profesional,
  - 25.3.2 - Komisioni statutar,
  - 25.3.3 – Komisioni për marrëdhënje ndërkombëtare,
  - 25.3.4 – Komisioni i trajnerëve,
  - 25.3.5 – Komisioni i referëve,
  - 25.3.6 – Udhëheqësin – selektorin e reprezentacionit, etj.e ndonjë detyre momentale
- 25.4 Këshilli drejtues, për kryerjen e ndonjë detyre momentale, formonë komisione apo trupa punues të përkohëshme, të cilët pushojnë me kryerjen e detyrës së caktuar.

## **Kryetari i FSHSK-së**

### Neni 26

- 26.1 Kryetari i FSHSK-së është edhe kryetar i Këshillit drejtues dhe kryesues i mbledhjeve të Kuvendit ndërmjet dy Kuvendeve zgjedhore.
- 26.2 Kryetarin e zgjedh Kuvendi nga radhët e delegatëve me mandat 4 vjeçar dhe mund të rizgjedhet përsëri.
- 26.3 Kryetari përfaqësonë FSHSK-në në bazë të Statutit dhe të akteve tjera të përgjithshme të FSHSK-së.
- 26.3.1 – Cakton mbledhjet e Këshillit drejtues dhe i kryesonë ato.
- 26.3.2 - Nënshkruan aktet e përgjithshme, vendimet dhe konkluzionet e nxjerra në organet që i kryesonë.
- 26.3.3 - Është urdhëdhënës i Shërbimit profesional të FSHSK-së.
- 26.3.4 - Kryen edhe punë tjera dhe detyra të caktuara me Statut, me aktet tjera të FSHSK-së ose me vendimet e organeve.
- 26.4 Kryetari mund të përmbahet nga zbatimi i vendimeve dhe konkluzioneve, apo propozimeve nga të gjitha organet e FSHSK-së, për të cilat mendonë se janë në kundërshtim me Statut, Ligj dhe në dëm të zhvillimit të sportit të shenjëtariisë, përveç vendimeve të Kuvendit.
- 26.5 Për këtë përmbajtje, kryetari është i obliguar t'a njoftoi Këshillin drejtues në afat prej 8 ditësh, kurse Kuvendin në mbledhjen e pare.
- 26.6 Kryetari i FSHSK-së për punën e vetë i përgjigjet Kuvendit.
- 26.7 Kryetari mund t'i mbartë autorizimet e veta në njerin nga nënkryetarët
- 26.7 Nënkryetarët e FSHSK-së e zavendësojnë kryetarin kur ai është i zënë ose mungonë në kryerjen e punëve dhe të detyrave të caktuara në pikat 26.3.1 deri 3 të Statutit, përkatësisht të Rregullorës mbi punën e Kuvendit të FSHSK-së.

## **Sekretari i FSHSK-së**

### Neni 27

- 27.1 Sekretarin e FSHSK-se e emronë Këshilli drejtues.
- 27.2 Kushtet të cilat duhet plotësuar personi i cili zgjidhet për Sekretar të FSHSK-së dhe të

drejtat dhe obligimet i caktonë Këshilli drejtues me akt të vaçant.

27.3 Sekretari i FSHSK-së është i obliguar që:

27.3.1 – të siguronë ligjmerinë e punës dhe rregullshmeritë tjera ose obligimet kontraktuese të FSHSK-së.

27.3.2 – përgjigjet për pregaditjen e materialit për mbledhjet e organeve të FSHSK-së.

27.3.3 – Kujdeset për kryerjen e vendimeve dhe të konkluzioneve të FSHSK-së.

27.3.4 – Siguronë transparencën e punës së FSHSK-së.

27.3.5 – Kryen edhe punë tjera të caktuara me Statut, me aktet tjera të përgjithshme dhe me vendime të organeve të FSHSK-së.

27.3.8 - Për punën e vetë Sekretari i përgjigjet Kryetarit dhe Këshillit drejtues të FSHSK-së.

### **Këshilli mbikëqyrës**

#### Neni 28

28.1 Këshillin mbikëqyrës e zgjedh Kuvendi i FSHSK-së.

28.2 Këshilli mbikëqyrës kontrollonë afarizmin e FSHSK-së.

28.3 Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej 3 anëtarëve dhe 3 zëvendës, të cilët në mes veti zgjedhin kryetarin.

28.4 Anëtari i Këshillit mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtar i organit tjetër punues të FSHSK-së.

28.5 Këshilli mbikëqyrës është i autorizuar:

28.5.1 – për kontrollimin e punëve financiare të FSHSK-së.

28.5.2 – për kontrollimin e punëve dhe obligimeve kontraktuese të FSHSK-së.

28.5.3 – për analizën e realizimit të planit financiar të FSHSK-së.

28.6 Shërbimi profesional dhe organet tjera të FSHSK-së janë të obliguara që Këshillit mbikëqyrës t'i ofrojnë të gjitha shenimet e kërkuara, t'i mundësojnë shiqimin e dokumentacionit dhe t'ia sigurojnë kushtet për punë.

28.7 Për punën e vetë Këshilli mbikëqyrës i përgjigjet Kuvendit dhe i raportonë Këshillit drejtues të FSHSK-së.

28.8 Për konstatimin e parregullsive, Këshilli mbikëqyrës e njofton Këshillin drejtues, përkatësisht Kuvendin e FSHSK-së, si dhe organin në punën e të cilit ka ndodhë parregullsia.

- 28.9 Nëse parregullsia e konstatuar nuk menjanohet në afatin e duhur, Këshilli mbikëqyrës është i obliguar që për këtë t'a njoftoi organin e autorizuar shtetëror.

### **Komisioni për anti-doping**

#### Neni 29

- 29.1 Përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtar.  
 29.2 Shqyrtonë çështjet medicinale që kanë të bëjnë me shenjëtari dhe hartonë udhëzime me propozime specifike mjeksore.  
 29.3 Mbeshtetë organizimin dhe në pajtim me Rregullat e lejuara nga ana e Këshillit drejtues dhe të ISSF-it, zbatonë kontrollën anti-doping.  
 29.4 I raportonë Këshillit drejtues dhe Kuvendit sipas nevojës.

### **Gjyqi i nderit**

#### Neni 30

- 30.1 Gjyqi i nderit është organ i FSHSK-së i autorizuar për vendosje për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve.  
 30.2 Gjyqi i nderit përbëhet prej tre anëtarëve dhe tre zavedës të anëtarëve, të cilët në mes veti zgjedhin kryetarin e Gjyqit të nderit.  
 30.3 Gjyqi i nderit vepron në bazë të Rregullorës disiplinore, me të cilin përcaktohen autorizimet, përgjegjësia disiplinore, procedura dhe masat disiplinore.  
 30.4 Shërbimi profesional i FSHSK-së, në bazë të kërkesës së kryetarit të Gjyqit të nderit, ofronë shërbime administrative teknike.

### **Arbitrazhi**

#### Neni 31

- 31.1 Të gjithë anëtarët e FSHSK-së, si dhe personat fizik të cilët janë anëtar të tyre, Pranojnë arbitrimin e gjyqit të zgjedhur të përhershëm të Komitetit Olimpik të Kosovës për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimeve definitive të organeve tëHK-së, kundër të cilave është kryer ose nuk egzistojnë mjete tjera juridike mbrojtëse para organeve të FSHSK-së.  
 31.2 Anëtarët dhe FSHSK-ja mund të kontraktojnë kompetencën e Gjyqit egzekutiv të Komitetit Olimpik të Republikës së Kosovës për të vendosë në kontestet e egzistua në lidhje me kryerjen e veprimtarive sportive, si dhe për ndërmjetësim për t'i pajtuar dhe për të vendosur në kontestet mbi të drejtat me të cilat mund të disponojnë lirisht,



nëse me ligj nuk është caktuar ekskluziviteti i kompetencës së vertetë i gjyqjeve ose i organeve tjera shtetërore të Kosovës.

## VII. PASURIA DHE VEPRIMTARIA MATERIALE-FINANCIARE

### Neni 32

- 32.1 Pasurinë e FSHSK-së e përbëjnë, pasuria e tundshme, të drejtat dhe mjetet monetare.
- 32.2 Federata i siguronë mjetet financiare nga pjesa e anëtarësisë, kotizimit, dotacionit nga Komiteti Olimpik – Departamenti i sportit i Republikës së Kosovës, mjetet nga sponzorimi, donatorët dhe burimet tjera ligjore.
- 32.3 Mjetet monetare, sipas rregullës, gjindën në xhirollogarinë e FSHSK-së..
- 32.4 Shpërndarja e mjeteve të gjithmbarshme financiare bëhet me Planin financiar në pajtim me rogramin e punës.
  - 32.4.1. Realizimi i fitimit eventual në afarizëm, me Planin financiar përcaktohet në vitin e ardhshëm për qëllime të përparimit të sportit të shenjëtarisë.
- 32.5 Plani financiar i FSHSK-së e aprovon, ndryshon dhe e plotësonë Kuvendi i FSHSK-së në propozim të Këshillit drejtues.
- 32.6 Urdhëdhënës për realizimin e Planit financiar të FSHSK-së është kryetari i FSHSK-së, kurse Këshilli drejtues me vendimin e vetë mund të caktoj edhe persona tjerë me autorizime në afarizmin materialo-financiar.
- 32.7 Afarizmi materialo-financiar i FSHSK-së organizohet dhe udhëheqet në pajtim me ligj dhe aktet e përgjithshme financiare të FSHSK-së.
- 32.8 FSHSK-ja mund të fitoj patundshmerinë, pasurinë e tundshme dhe të drejtat.
- 32.9 Vendimin për shitjen, mbartjen ose tjetërsimet tjera ose ngarkesën me patundshmeri dhe të drejta e bjenë Kuvendi i FSHSK-së në propozim të Këshillit drejtues.
- 32.10 Në rast të pushimit të punës të FSHSK-së pasurinë e patundshme të saj, pasuria e tundshme dhe të drejtat do t'i dorëzohen në qeverisje Komitetit Olimpik të Kosovës, me kusht që nëse në dhjet vitet e ardhshme formohet FSHSK-ja e re ose organizatë tjetër e sportit të shenjëtarisë, i njëjti është i obliguar që pasurinë e marrur t'ia dorëzoj asaj FSHSK-je.
  - 32.11.1 Mjetet monetare do të përdoren për pagesën e obligimeve të arritura të FSHSK-së,

kurse shuma e mbetur do t'u shpërndahet në pjesë të njejta anëtarëve.

## VIII. PUNËT ADMINISTRATIVE PROFESIONALE

### Neni 33

- 33.1 Punët administrative, teknike, profesionale dhe të tjera i kryen një numër i caktuar i veprimtarëve në bazë të Rregullorës mbi sistematizimin e vendeve të punës në punët e Shërbimit profesional të FSHSK-së.
- 33.2 Mjetet për të ardhura dhe punë të punëtorëve në FSHSK, sigurohen me Plan financiar në pajtim me Programin e punës së FSHSK-së.
- 33.3 Në Shërbim profesional nuk mund të mbartën punët dhe detyrat për të cilat vendosin organet e FSHSK-së.

## IX. PUSHIMI I PUNËS SË FSHSK-së

### Neni 34

- 34.1 FSHSK-ja pushonë së punuari kur plotësohen parakushtet Ligjore ose me vendimin e Kuvendit të FSHSK-së.
- 34.2 Vendimi mbi pushimin e punës së FSHSK-së mirret me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.
- 34.3 Në rast të prerjes së punës të FSHSK-së, pasuria e FSHSK-së me vendimin mbi pushimin e punës do të shpërndahet në mënyrë të paraparë në pikat 32.10 dhe 32.11.1 të këtij Statuti.

## X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 35

- 35.1 Këtë Statut si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tijë, e aprovonë Kuvendi i FSHSK-së në bazë të vërejtjeve dhe propozimeve të anëtarëve – delegatëve.
- 35.2 Skjarimet e dispozitave të Statutit i jep Kuvendi i FSHSK-së.
- 35.3 Të gjitha Klubet e shenjëtarise në Kosovë janë të obliguar që t'i harmonizojnë statutet e veta me këtë Statut, në afat prej 90 ditësh prej ditës së hyrjes tij në fuqi.

35.4 Statuti hynë në fuqi ditën e aprovimit.

35.5 Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve të këtij Statuti, pushojnë të vlejshme dispozitat e Statutit të aprovuar më 27.01.2007.

35.6 Sherbimi profesional i FSHSK-së, është i obliguar që aktet normative t'i harmonizoi me tekstin e ri të Statutit në afat prej 6 muaj.

Në Prishtinë, 17.05.2008.

K R Y E T A R I  
I FEDERATËS SË SHENJËTARISË  
SPORTIVE TË KOSOVËS,  
ALI PLLANA, ecc i dipl.